



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1299/12 Prot.

Tiranë, më 28/05/2025

V E N D I M

Nr. 23, datë 28.05.2025

PËR

**MIRATIMIN E SHPËRNDARJES TË KUOTAVE TË MIRATUARA PËR PROGRAMIN
E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT “MASTER PROFESIONAL NË RESTAURIM
MONUMENTESH KULTURE” SIPAS KATEGORIVE, NË FAKULTETIN E
ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË
TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit Nr. 04, datë 21.01.2025 “Një shtesë dhe një ndryshim në Udhëzimin Nr. 06, datë 19.02.2018 ‘Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit’”, i ndryshuar, VKM 41, datë 24.01.2018, pika 2.7, Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies, neni 18, pika 2, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, mbështetur në propozimin e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, dhe në Relacionin e ardhur nga Drejtoria e Kurrikulave, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e shpërndarjes të kuotave të miratuara për programin e ciklit të dytë të studimit “Master Profesional në Restaurim Monumentesh Kulture” ndërmjet kategorive, pa tejkaluar kapacitetin maksimal pritës për këtë program studimi të miratuar dhe deklaruar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, për vitin akademik 2024-2025.
2. Rishpërndarja e kuotave të bëhet sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

Kuotat e pranimit, për vitin akademik 2024-2025: FAU

Nr.	IAL	Njësia kryesore	Programi i studimit	Shuma e kuotave	Kuotat sipas programit të studimit për kandidatët												
					Shqiptarët brenda vendit	Që aplikojnë për program të dytë	Që aplikojnë për transferim studimesh	Të huaj	Me statusin e jetimit	Persona me aftësi të kufizuar	Romë+ballkano egjiptian	Trojet					
												Kosovë	RMV	Mal i Zi	Preshevë	Bujanovc	Medvegjë
1	Universiteti Politeknik i Tiranës	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn	35	30	1	0	0	0	0	0	1	1	1	1	0	0
2			Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Arkitekt	100	90	2	1	1	0	0	0	1	1	1	1	1	1
3			Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Urbanist	55	50	0	2	0	0	0	0	1	1	1	0	0	0
4			Master Profesional në Restaurim Monumentesh Kulture	35	14	11	0	2	0	0	0	0	2	2	2	2	



